FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.5 16 shkurt 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7247 datë 25.1.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	145
Dekret nr.7248 datë 26.1.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	145
Dekret nr.7249 datë 30.1.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	146
Vendim i KM nr.88, datë 7.2.2012	Për një ndryshim në vendimin nr.502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit"	147
Urdhër i MTKRS nr.18, datë 23.1.2012	Për licencimin e agjencisë së administrimit "AMP", Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Producentëve	147
Vendim i GJK nr.3, datë 3.2.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "d" të nenit nr.4 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar me nenin 3 të ligjit nr.10 111, datë 2.4.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist"".....	149
Vendim i BSH nr.2, datë 16.1.2012	Për miratimin e rregullores "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"	153

DEKRET
Nr.7247, datë 25.1.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Isak Nuhi Bilalli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.7248, datë 26.1.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Shota Azem Baraliu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.7249, datë 30.1.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Rudina Njazi Goxharaj
2. Brisilda Agim Mulla
3. Aida Hasan Selhanej
4. Orjola Shefqet Duravaku
5. Majlinda Veli Alliaj
6. Selvie Mehill Luxen (Leka)
7. Fejzulla Hamdi Çullhaj
8. Diana Ndue Bardeli (Gega)
9. Bledian Mehmet Mehmeti
10. Nino Petrit Gjoni
11. Ali Mehmet Mehmeti
12. Florent Haki Cerhozi
13. Romeo Llazi Gjermeni
14. Marjana Vangjel Beqiri (Naqo)
15. Ela Rapush Seitz (Barjamaj)
16. Ervin Qamil Gjuzi
17. Ornela Besnik Fëllanxa
18. Holger Albert Hidri
19. Bledar Robert Karajani
20. Holti Fatos Këllezi
21. Fize Qani Likaj-Makolli (Likaj)
22. Rezart Agron Qelibari
23. Blerim Hiqmet Hoxha
24. Jennifer Ferid Kurti
25. Elma Eqrem Beqiri (Sheqeri)
26. Enea Skender Doda
27. Stela Pellumb Shahini
28. Eglantina Agim Böckmann (Rapo)
29. Suela Shpetim Kaçaça (Kacaca)
30. Gjergji Roberto Radoja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.88, datë 7.2.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.502, DATË 13.7.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES UNIFORME TË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e nenit 47 të "Rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", miratuar me vendimin nr.502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Vendimet e miratuara nga KRRTRSH-ja, para fillimit me efekte të plota të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, mbeten në fuqi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr.18, datë 23.1.2012

PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT "AMP", AGJENCIA E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË PRODUCENTËVE

Duke marrë parasysh kërkesën dhe dosjen me dokumentacionin e agjencisë "AMP", propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.1267 prot., datë 23.12.2011 për licencimin e kësaj agjencie në fushën e menaxhimit të të drejtave të producentëve,

konstatova se:

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar, është kompetencë e Ministrit miratimi i dhënies së licencës së kësaj agjencie.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, dhe të neneve 108 dhe 109 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e agjencisë së administrimit "AMP", Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Producentëve.

2. Afati i licencës është tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
Aldo Bumçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT
MINISTRI

LIÇENCË

Nr 05 **Dt.** 23.01. **2012**

Në mbështetje të ligjit Nr. 9380, dt 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të", i ndryshuar, dhe V.K.M Nr. 232, datë 19.04.2006, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, mbasi konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga Agjensia "**AMP**", është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për të drejtat e autorit dhe të tjera të lidhura me të,

VENDOSI:

Të licencojë subjektin "AMP"

si Agjenci e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Lidhura me të Drejtën e Autorit për Producentët (prodhues), sipas të gjitha formave të njohura nga teknologjia

Ky subjekt është i njohur si person juridik me Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.3175, datë 11.10.2011, me Seli: Rr. "Andon Zako Cajupi", kati I, Tiranë, Shqipëri.

Përfaqësuesi Ligjor i AMP: Z. ZAMIR SUKNIQI

Licenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare
Kjo licencë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Licenca duhet të ekspozohet në zyrat e agjencisë.

MINISTRI

ALDO BUMÇI

VENDIM
Nr.3, datë 3.2.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i “	“
Admir Thanza	Anëtar	i “	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 24.11.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 47/22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata e ish-të Burgosurve Politikë të Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari z. Tanush Kaso.

Shoqata e Trashëgimtarëve të të Pushkatuarve Politikë të Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari z. Gjoc Gjoçi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Çefa.

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i shkronjës “d” të nenit nr.4 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar me nenin 3 të ligjit nr.10111, datë 2.4.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist””.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 69 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë; neni 4 i Protokollit nr.7 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut, neni 14 i Kartës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut (Pakti Ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesit e kërkuesve, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”. Ky ligj ka për objekt dëmshpërblimin financiar të ish-të dënuarve politikë, familjarëve të viktimave të ekzekutuara apo të pushkatuara padrejtësisht për motive politike, si dhe të internuarve ose të dëbuarve. Ligji, në nenin 4, ka përcaktuar “kriteret për të përfituar dëmshpërblim”, njëri prej të cilave është se “sipas

vendimit gjyqësor të formës së prerë, të mos ketë kryer veprime të dëmshme, me pasoja për jetën e shtetasve të tjerë" (shkronja "d" e nenit 4).

Ligji nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist" ka pësuar ndryshime me ligjin nr.10111, datë 2.4.2009, i cili ndër të tjera në nenin 3 të tij parashikon se: "në nenin 4, në fund të shkronjës "d", pas fjalëve "për jetën e shtetasve të tjerë" shtohen fjalët "gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991".

Kërkuesit kërkojnë shfuqizimin e shkronjës "d" të nenit nr. 4 të ligjit nr.9831 datë 12.11.2007, ndryshuar me nenin 3 të ligjit nr.10111, datë 2.4.2009, duke pretenduar se kjo dispozitë:

- Cenon parimin kushtetues të mosgjykimit sërish dhe të mosdënimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale, të parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës, në nenin 4 të protokollit 7 të KEDNJ-së dhe nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, për shkak se një numër i konsiderueshëm shtetasish që i përkasin shtresës të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, ndëshkohen për të dytën herë lidhur me një vepër penale të kryer para një periudhe 20 deri 65 vjeçare.

- Cenon parimin kushtetues të barazisë përpara ligjit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, sepse prodhon efekte vetëm mbi një kategori të caktuar shtetasish të kësaj shtrese, duke i vendosur ata haptazi në pozita diskriminuese në raport me ish-të dënuarit politikë të tjerë që nuk i përfshin parashikimi i dispozitës së kundërshtuar.

- Kufizimi që i bëhet kësaj kategorie nëpërmjet kësaj dispozite nuk gjen mbështetje në neni 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak se dëmtimi i jetës së tjetrit, mund të ndodhë edhe në kushte të tilla si pakujdesia, kapërcimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme, gabim në objekt (rast fatkeq) etj.

- Cenon parimin e rehabilitimit të parashikuar në nenin 69 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, sepse një numër i konsiderueshëm shtetasish që kanë vuajtur krahas dënimit politik edhe dënime të natyrës ordinere për vepra të kryera në dëm të jetës dhe shëndetit të të tjerëve, nuk konsiderohen të padënuar (te rehabilituar) lidhur me veprën penale të kryer në dëm të jetës dhe shëndetit të tjetrit, edhe pse nga dita e vuajtjes së dënimit për këtë vepër penale, mund të ketë kaluar afati më i gjatë i rehabilitimit, i parashikuar nga shkronja ç) e nenit 69 germa "ç" të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

- Cenon parimin e mospasjes së fuqisë prapavepruese të ligjit, pasi subjektet që aktualisht privohen nga e drejta për të përfituar dëmshpërblim në kuadër të ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist" kanë qenë përfitues si gjithë bashkëvuajtësit e tjerë, në raport me dënimin politik të vuajtur prej tyre.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtroi këto prapësime:

- Kërkesa objekt gjykimi është paraqitur para Gjykatës Kushtetuese jashtë afatit të përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr.8577 datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", sepse shkaqet e saj i referohen kriterit të vendosur në shkronjën "d" të nenit 4 të ligjit bazë nr.9831, datë 12.11.2007 "*Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist*", dhe jo periudhës kohore brenda së cilës do të duhet të veprojë kriteri i dëmshpërblimit, e përcaktuar nëpërmjet ndryshimeve që shkronja "d" e nenit 4 të ligjit bazë ka pësuar me ligjin nr. 10111, datë 2.4.2009.

- Përfaqësuesit e kërkuesve kanë marrë pjesë në mbledhjet e zhvilluara nga Kuvendi i Shqipërisë me grupet e interesit, në funksion të miratimit të ligjit objekt shqyrtimi.

- Kriteret për fitimin e së drejtës për dëmshpërblim financiar, të përcaktuara nga shkronja "d" e nenit 4 të ligjit bazë, nuk cenojnë urdhërimet e neneve 17,18 dhe 34 të Kushtetutës dhe të

nenit 69/c të Kodit Penal, sepse nuk parashikojnë gjykimin sërish dhe dënimin më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale, sepse këto kritere kanë qenë përcaktuar edhe në ligjet e mëparshme që kanë rregulluar këtë të drejtë, dhe se subjektet e kësaj norme janë vetëm të dënuarit politikë të regjimit komunist dhe midis kësaj shtrese ky ligj nuk krijon asnjë diferencim; e drejta për dëmshpërblim financiar e përcaktuar nga kjo dispozitë nuk ka lidhje dhe nuk barazohet apo krahasohet me rehabilitimin e të dënuarve të tjerë.

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, duke kërkuar po rrëzimin e kërkesës, parashtroi këto prapësime:

- Kërkuesit nuk legjitimohen që të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës objekt shqyrtimi, sepse në kërkesën e paraqitur para Gjykatës Kushtetuese nuk kanë përmbushur kushtin për përcaktimin mjaftueshmërisht të saktë të fakteve që justifikojnë se ato kryejnë një veprimtari ligjore, e cila pritet dhe influencohet drejtpërdrejt, në mënyrë të sigurt dhe personalisht, nga zbatimi i ligjit nr.10111, datë 2.4.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9831, datë 12.11.2007, "*Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist*".

- Kërkimi për antikushtetutshmërinë e kritereve të përcaktuara në shkronjën "d" të nenit 4 të ligjit bazë, ka rënë në dekadencë, për shkak se ka kaluar afati 3-vjeçar i përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr.8577 datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe në këtë aspekt kompetenca e Gjykatës Kushtetues në shqyrtimin e tij pengohet nga "*ratione temporis*".

- Norma objekt shqyrtimi nuk cenon nenet 17, 18 dhe 34 të Kushtetutës, sepse ndalimet kushtetuese për dënimin dy herë për të njëjtën vepër penale nuk janë të zbatueshme në procedurën e shqyrtimit administrativ të dëmshpërblimit financiar, dallimi në trajtim për shkak të ndalimit të formuluar nga kjo dispozitë nuk është diskriminues, sepse ndjek një "qëllim të ligjshëm", mbrojtjen dhe respektin e jetës së të tjerëve, duke krijuar një marrëdhënie të arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet".

- Pretendimi se norma objekt shqyrtimi bie në kundërshtim me nenin 69/c të Kodit Penal bazuar në vendimin nr.35/2007 të Gjykatës Kushtetuese, nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

II

Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar për moslegjitimimin e kërkuesve.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) në lidhje me këtë pretendim vëren se bazuar në dispozitat kushtetuese, dhe ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese, legjitimiteti i kërkuesit përbën një nga parakushtet procedurale për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata), bazuar në aktet e formimit të kërkuesve, çmon se kërkuesit përfshihen në rrethin e subjekteve "*organizata të tjera*" të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, të cilat kanë legjitimitet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Referuar pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese sepse objekti i ligjit të kundërshtuar për papajtueshmëri me Kushtetutën është përcaktimi i përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit financiar për ish-të dënuarit politikë, ndërkohë që qëllimi i kërkuesve është mbrojtja e të drejtave të ish-të dënuarve politikë, të sanksionuara nga legjislacioni vendas si dhe nga aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Në këto kushte, ekziston edhe lidhja e domosdoshme ndërmjet qëllimit për të cilin janë krijuar të dy shoqatat dhe çështjes kushtetuese të ngritur prej tyre. Për më tepër, Gjykata konstaton se legjitimimi i njërit prej kërkuesve dhe konkretisht "*Shoqatës së ish-të Burgosurve Politikë të Shqipërisë*" në lidhje me ligjin në të cilin përfshihet norma e kundërshtuar, është verifikuar edhe më parë si pasojë e gjykimit kushtetues të iniciuar edhe prej këtij subjekti në përfundim të të cilit Gjykata Kushtetuese ka dhënë vendimin e saj nr.4, datë 12.02.2010.

Gjykata, referuar legjitimimit "*ratione temporis*", vë në dukje se në nenin 50 të ligjit nr. 8577 datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar se "*kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre*". Gjykata, në këtë aspekt, bazuar në datën e regjistrimit të kërkesës vlerëson se kompetenca e Gjykatës pengohet "*ratione temporis*" për të shqyrtuar çështjen e pajtueshmërisë me Kushtetutën të përmbajtjes së normës ligjore të parashikuar në shkronjën "d" të nenit 4 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "*Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist" me Kushtetutën*.

III

Gjykata, bazuar në sa më sipër, pa iu futur themelit të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, konstaton se këto pretendime i referohen kriterit të vendosur në shkronjën "d" të nenit 4 të ligjit bazë nr.9831, datë 12.11.2007 "*Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist*", dhe jo periudhës kohore, 30.11.1944 deri më 1.10.1991, brenda së cilës do të duhet të veprojë kriteri i dëmshpërblimit, periudhë e përcaktuar nëpërmjet ndryshimeve që shkronja "d" e nenit 4 të ligjit bazë ka pësuar me nenin 3 të ligjit nr.10111, datë 2.4.2009. Gjithashtu, edhe gjatë gjykimit në seancë plenare përpara Gjykatës Kushtetuese, kërkuesit iu përmbajtën të njëjtave pretendime të parashtruara në kërkesë, duke mos ngritur asnjë pretendim në lidhje me këtë periudhë kohore.

Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesa nuk mund të merret në shqyrtim, për shkak se është paraqitur tej afatit ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "a" të Kushtetutës, nenit 134, pika 1, shkronja "f", nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, Petrit Plloçi

VENDIM
Nr.2, datë 16.1.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI PROCEDURAT E NDËRHYRJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3 pika 2, të nenit 43 shkronja "c" dhe të nenit 61 shkronja "a" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të vendimit qarkullues nr.64, datë 20.7.2005 të Këshillit Mbikëqyrës "Për krijimin e Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare"; si dhe të rregullores nr.16, datë 9.3.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare", me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.75, datë 11.10.2006 për miratimin e rregullores "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore", të ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
MBI PROCEDURAT E NDËRHYRJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore.

Neni 2
Baza ligjore

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje me:

a) ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 3, pika 2; neni 43, shkronjat "a", "b" dhe "c"; neni 60, pika 2 dhe neni 61, shkronja "a";

b) vendimin nr.64, datë 20.7.2005 të Këshillit Mbikëqyrës "Për krijimin e Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare";

c) rregulloren "Për organizimin edhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.16, datë 9.3.2011;

d) rregulloren "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, nr.53, datë 21.6.2000, të ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Qeveria" është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

b) "Banka" është Banka e Shqipërisë.

c) "Bankat dhe degët e bankave të huaja" janë personat juridikë të licencuar nga Banka për ushtrimin e veprimtarisë bankare, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

d) "*Spot*" është marrëveshja e këmbimit valutor, sipas së cilës palët bien dakord për kursin e këmbimit dhe kalimin e fondeve në llogaritë e secilës prej tyre, deri në 2 (dy) ditë pune pas datës së lidhjes së marrëveshjes.

e) "*Forward*" është marrëveshja e këmbimit valutor, sipas së cilës palët bien dakord për kursin e këmbimit dhe për kalimin e fondeve në llogaritë e secilës prej tyre në një datë të caktuar, e cila është më tepër se 2(dy) ditë pune pas datës së lidhjes së marrëveshjes.

f) "*Swap*" është blerja dhe shitja e njëkohshme, por me datë-valutë të ndryshme, e një monedhe kundrejt një tjetre.

g) "Datë-valutë" është data për të cilën dy kundërpalë bien dakord paraprakisht për kalimin e fondeve në llogarinë e njëri–tjetrit, në përmbushje të një transaksioni valutor.

h) "Kuotim" është shprehja e gatishmërisë së Bankës dhe/ose partnerit të tregtimit për të tregtuar një monedhë të huaj kundrejt lekut.

i) "Sterilizim" është shitja ose blerja me të drejta të plota e titujve të Qeverisë, për të minimizuar efektin në tregun e parasë që vjen si rezultat i ndërhyrjes në tregun valutor.

j) "Partnerët e tregtimit" janë bankat dhe degët e bankave të huaja dhe/ose zyrat e këmbimit valutor.

k) "Procedura e ndërhyrjes" është mënyra e propozimit, e marrjes së vendimit dhe e realizimit të ndërhyrjes në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore nga Banka.

l) "Ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor" është ndikimi që i bën Banka kërkesës dhe/ose ofertës për lekë ndaj monedhave të huaja.

m) "Lloj i ndërhyrjes" është mënyra që përdor Banka për të ndikuar kërkesën dhe/ose ofertën për lekë ndaj monedhave të huaja.

n) "Instrument i ndërhyrjes" është mjeti që përdor Banka për të realizuar llojin e ndërhyrjes.

o) "Ndërhyrja me veprim" është çdo kontaktim verbal ose/dhe në rrugë elektronike nga ana e Bankës me partnerët e tregtimit, me synim blerjen apo shitjen e monedhës së huaj kundrejt monedhës vendase, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve spot ose forward, ose anulimin e ankandit për shitblerjen e valutës. Ndërhyrja me veprim paraqitet në formën e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë dhe ndërhyrjes me ankand.

p) "Ndërhyrje e drejtpërdrejtë" është kuotimi i Bankës për partnerët e tregtimit, që synon lidhjen e marrëveshjeve *spot* ose *forward* për shitjen ose blerjen e valutave mes Bankës dhe partnerëve të tregtimit.

q) "Ndërhyrje me ankand" është lajmërimi nga Banka për ankand, për shitjen ose blerjen e valutës kundrejt monedhës vendase nga bankat dhe degët e bankave të huaja, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve *spot* ose *forward*.

r) "Mënyra e realizimit të ndërhyrjes me veprim" janë rregullat e caktuara për përzgjedhjen e partnerëve në tregtim, për përcaktimin e shumës së tregtuar dhe të çmimit të tregtimit.

s) "Ndërhyrje me deklaratë" është çdo deklaratë verbale apo e shkruar e Bankës, në lidhje me nivelin e kursit të këmbimit të lekut kundrejt monedhave të huaja.

t) "Transaksione valutore tregtare" janë blerjet ose shitjet e monedhës vendase kundrejt monedhës së huaj, të cilat kryhen me Qeverinë, me institucione të tjera financiare ndërkombëtare dhe klientë të tjerë përveç partnerëve të tregtimit.

u) "Çrregullim i tregut të brendshëm valutor" është:

i. mungesa e likuiditetit si rezultat i së cilës partnerët e tregtimit nuk janë në gjendje të mbajnë pozicione të hapura dhe rrezikojnë tërheqjen e tyre nga tregu, gjë që rezulton në vështirësimin e këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja;

ii. rritja e ritmit të ndryshimit në një kah e kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja ose rritja e luhatshmërisë së kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja, në kushtet e mungesës së informacionit të ri në treg;

iii. zgjerimi i diferencës midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja, të cilat kuotohen në tregun valutor;

iv. ndryshimi i përbërjes dhe i vëllimit të veprimeve që kryhen në tregun valutor;

v. mosfunksionimi i qarkullimit të valutës nga ofruesit deri te kërkuesit e saj.

v) "Tregu i brendshëm valutor" është tregu ku kryhet aktiviteti i këmbimit valutor nga partnerët e tregtimit në Republikën e Shqipërisë.

w) "Kursi i këmbimit" është çmimi i monedhës vendase kundrejt një njësie të monedhës së huaj.

x) "Kursi i tregut për transaksionet tregtare" është kursi i llogaritur në mënyrë të njëjtë me kursin zyrtar të këmbimit, në momentin e kryerjes së transaksioneve tregtare.

y) "Limit" është shuma maksimale që bankat dhe degët e bankave të huaja janë të gatshme të tregtojnë me Bankën, në një transaksion të vetëm dhe gjatë një dite. Limitet i komunikohen Bankës me anë të një shkrese zyrtare në Departamentin e Operacioneve Monetare dhe mund të rishikohen jo më shpesh se një herë në gjashtë muaj.

z) "Pezullim i kontaktimit" është përjashtimi i përkohshëm i një banke ose dege të bankës së huaj, si partner tregtimi gjatë ndërhyrjes me veprim.

aa) "Komiteti" është Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare në Bankë.

KREU II
PROCESI I VENDIMMARRJES

Neni 4
Objektivat e ndërhyrjes në tregun valutor

Objektivat e ndërhyrjes së Bankës në tregun valutor janë:

a) shmangia e çrregullimeve të tregut të brendshëm valutor;

b) përshtatja e kursit të këmbimit me nivelin e përcaktuar nga faktorët bazë makroekonomikë; dhe

c) rritja ose ulja e rezervës valutore.

Neni 5
Ndërhyrja për shmangien e çrregullimeve në tregun valutor

Komiteti ose Guvernatori vendos për ndërhyrjen në tregun valutor për arritjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja "a" të kësaj rregulloreje. Komiteti vendos mbështetur në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare.

Neni 6
Ndërhyrja për përshtatjen e nivelit të kursit të këmbimit

Këshilli Mbikëqyrës vendos për ndërhyrjen në tregun valutor për arritjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja "b" të kësaj rregulloreje, mbështetur në propozimin e Departamentit të Politikës Monetare.

Neni 7
Ndërhyrja për rritjen e rezervës valutore

Komiteti, bazuar në programin monetar të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës dhe mbështetur në propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, vendos për ndërhyrjen në tregun valutor, për arritjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja "c" të kësaj rregulloreje.

Neni 8
Vendimet për ndërhyrje

1. Në vendimet që merr për ndërhyrjen në tregun valutor, sipas kësaj rregulloreje, Komiteti përcakton:
a) objektivin e ndërhyrjes;
b) llojin e ndërhyrjes (me deklaratë ose/dhe me veprim);
c) instrumentin e ndërhyrjes; dhe
d) kohëzgjatjen e ndërhyrjes.
2. Komiteti mund të përfshijë në vendimet e tij edhe elemente të tjera, të tilla si:
a) skedulin paraprak të ankandeve;
b) llojin e marrëveshjes, *spot* ose *forward*;
c) shumën maksimale të ndërhyrjes; dhe/ose
d) sterilizimin ose jo të ndërhyrjes.
3. Guvernatori vendos për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor vetëm në llojin e ndërhyrjes me deklaratë.

KREU III
ZBATIMI I VENDIMEVE PËR NDËRHYRJE

Neni 9
Partnerët e tregtimit

1. Banka, si rregull, i kryen ndërhyrjet në tregun valutor nëpërmjet bankave dhe degëve të bankave të huaja.
2. Në raste të veçanta, kur nuk funksionon tregtimi nëpërmjet bankave dhe degëve të bankave të huaja, Banka kryen ndërhyrjet në tregun valutor nëpërmjet zyrave të këmbimit valutor.

Neni 10
Instrumentet e ndërhyrjes sipas llojit

1. Banka kryen ndërhyrjet në tregun valutor nëpërmjet instrumenteve të mëposhtme:

a) Deklaratë në median e shkruar, median elektronike dhe/ose konferencë shtypi, në rastin e ndërhyrjes me deklaratë.

b) Kontaktimit të partnerëve të tregtimit me synim lidhjen e marrëveshjes së menjëhershme, ose lajmërimit për organizimin e ankandit me bankat dhe degët e bankave të huaja për blerje ose shitje valute, nëpërmjet transaksioneve *spot* ose *forward*, në rastin e ndërhyrjes me veprim.

Neni 11
Monedhat e ndërhyrjes

1. Për realizimin e ndërhyrjes me veprim, sipas kësaj rregulloreje, Departamenti i Operacioneve Monetare përdor monedhën e përbashkët europiane (EURO) ose dollarin amerikan (USD).

2. Departamenti i Operacioneve Monetare nuk mund të kuotojë të dyja monedhat njëkohësisht.

Neni 12
Realizimi i ndërhyrjes në tregun valutor

1. Ndërhyrja me deklaratë në emër të Bankës realizohet nga Guvernatori i Bankës ose nga një prej anëtarëve të Komitetit, pas marrjes së autorizimit të Guvernatorit ose Komitetit.

2. Departamenti i Operacioneve Monetare realizon ndërhyrjen me veprim në tregun valutor, në zbatim të vendimit të marrë sipas neneve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje.

3. Departamenti i Operacioneve Monetare, duke synuar rritjen e efektivitetit të ndërhyrjes në tregun valutor, përcakton numrin e ndërhyrjeve dhe momentin e realizimit të ndërhyrjes me veprim në tregun valutor.

4. Komiteti vendos për mënyrën e realizimit të ndërhyrjes me veprim, në rastet kur ndërhyrja kryhet me zyrat e këmbimit valutor, siç parashikohet në nenin 9 pika 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 13
Mënyra e realizimit të ndërhyrjes me veprim

Ndërhyrja me veprim në tregun e brendshëm valutor përcaktohet nga vendimi i Komitetit.

I. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë

Departamenti i Operacioneve Monetare, në përputhje me vendimin e Komitetit, përcakton elementet e realizimit të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë, të cilat përbëhen nga:

a) përzgjedhja e partnerëve të tregtimit;

b) përcaktimi i kursit të këmbimit; dhe/ose

c) përcaktimi i shumës së ndërhyrjes.

A. Përzgjedhja e partnerëve të tregtimit bëhet si vijon:

1. Departamenti i Operacioneve Monetare përcakton numrin e bankave dhe degëve të bankave të huaja, të cilat do të jenë partnerët e tregtimit të Bankës për ndërhyrjet në tregun valutor. Ky numër në çdo rast, nuk mund të jetë më i vogël se 4 (katër).

2. Kriteret për përzgjedhjen e bankave dhe degëve të bankave të huaja si partnerë tregtimi janë:

i) konkurrueshmëria e kurseve të këmbimit; dhe/ose

ii) limitet e përcaktuara nga bankat dhe degët e bankave të huaja.

3. Në rast se bankat dhe degët e bankave të huaja nuk respektojnë limitin, në lidhje me transaksionet në të cilat Banka kërkon të hyjë me to, nëpërmjet një kursi të kuotuar prej tyre, Banka pezullon kontaktimin me to.

4. Vendimi për pezullimin e kontaktimit të bankës ose degës së bankës së huaj në përputhje me pikën 3 të këtij neni, merret nga Departamenti i Operacioneve Monetare, deri në mbledhjen e ardhshme të Komitetit, i cili vendos mbi kohëzgjatjen e mëtejshme të pezullimit të kontaktimit, që në çdo rast nuk mund të tejkalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, gjatë të cilave Banka është e pranishme në tregun valutor.

5. Banka njofton bankat dhe degët e bankave të huaja me shkresë zyrtare për vendimin e Departamentit të Operacioneve Monetare dhe/ose Komitetit, në rast pezullimi të kontaktimit.

B. Kursi i ndërhyrjes në tregun valutor përcaktohet nga:

a) kuotimet e bankave të nivelit të dytë; ose

b) kuotimi i Departamentit të Operacioneve Monetare; ose

c) kombinimi i shkronjave të mësipërme, “a” dhe “b”.

C. Shuma e ndërhyrjes në tregun valutor përcaktohet nga:

a) limitet e miratuara të bankave dhe degëve të bankave të huaja; ose

b) vendimi i Departamentit të Operacioneve Monetare; ose

c) kombinimi i shkronjave të mësipërme, “a” dhe “b”.

II. Ndërhyrja me ankand

Ndërhyrja me ankand realizohet vetëm me bankat dhe degët e bankave të huaja.

A. Shuma e ofruar në ankand nga partnerët e tregtimit duhet të plotësojë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) të jetë maksimalisht në shumën 5,000,000.00 euro ose ekuivalentin e saj;

b) të jetë e barabartë me limitin që i është paraqitur Bankës për tregtim; dhe

c) të jetë një shumë e vetme.

B. Departamenti i Operacioneve Monetare përcakton fituesit në ankand bazuar në:

a) konkurrueshmërinë e kurseve të këmbimit të ofruara nga bankat dhe degët e bankave të huaja;

b) shumën që do të blihet/shitet në ankand.

C. Departamenti i Operacioneve Monetare ka të drejtë të refuzojë çdo ofertë në ankand kur vlerëson se pranimi i saj mund të nxisë çrregullime në tregun e brendshëm valutor.

D. Lidhja e marrëveshjeve shtesë pas organizimit të ankandit

Në përfundim të çdo ankandi, Departamenti i Operacioneve Monetare, duke gjykuar në bazë të rezultateve të tij dhe informacioneve të tjera, ka të drejtë t’i ofrojë pjesëmarrësve fitues mundësinë për të tregtuar me të njëjtin kurs, një shumë shtesë deri në dyfishin e shumës së ofruar në ankand. Kontaktimi i bankave dhe degëve të bankave të huaja nga Banka, do të bëhet brenda 60 minutave pas orës së zhvillimit të ankandit, duke filluar nga banka dhe dega e bankës së huaj me kursin më konkurrues në ankand.

Neni 14
Anulimi i ankandit

1. Komiteti, me propozim të Departamentit të Politikës Monetare ose Departamentit të Operacioneve Monetare, anulon në çdo moment një ose disa ankande para kryerjes së tij ose tyre.

2. Komiteti vendos për anulimin e ankandit me propozim të Departamentit të Politikës Monetare, në rastet kur flukset e valutës janë përtej parashikimeve mbi të cilat është bazuar ndërhyrja me ankand.

3. Komiteti vendos për anulimin e ankandit me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, kur gjykohet se organizimi i ankandit mund të nxisë çrregullime në tregun e brendshëm valutor.

Neni 15
Konfidencialiteti

1. Të gjitha propozimet dhe diskutimet për marrjen e një vendimi për të ndërhyrë në tregun valutor trajtohen si informacion jopublik profesional, në përputhje me kushtet dhe kërkesat e rregullores nr.53, datë 21.6.2000 "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore për sekretin në Bankë.

2. Vendimet për të ndërhyrë në tregun valutor trajtohen si informacion jopublik profesional, sipas pikës 1 të këtij neni, deri në momentin e njoftimit dhe publikimit të tyre në përputhje me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

Neni 16
Njoftimi dhe publikimi

1. Banka në raportet e saj periodike të publikuara, informon mbi ndërhyrjet në tregun valutor, si dhe publikon shumën e ndërhyrjes së saj në përputhje me rregulloren nr.53, datë 21.6.2000 "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Lajmërimi për organizimin e ankandit nga Banka bëhet të paktën 30 ditë kalendarike përpara zhvillimit të tij. Ky lajmërim përmban datën, llojin e monedhës, orën e kryerjes së ankandit dhe shumën.

3. Banka lajmëron bankat dhe degët e bankave të huaja me të paktën një nga mjetet e komunikimit (Reuters, Bloomberg, internet ose çdo mjet tjetër që e gjykon të arsyeshme).

4. Banka lajmëron partnerët e tregtimit me të cilët ka kontakte për kursin e këmbimit dhe me të cilin realizon ndërhyrjet me veprim në tregun valutor, në rast se kursi i këmbimit është i të njëjtës vlerë për të gjithë partnerët.

5. Banka nuk publikon ose nuk komunikon kursin e ndërhyrjes në tregun valutor, në rast se ndërhyrjet me veprim kryhen me kurse këmbimi me vlera të ndryshme, por publikon me mjetet e saj të komunikimit dhe i komunikon partnerëve të tregtimit, faktin që ka ndërhyrë në tregun valutor, në rastin e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta.

6. Në rastin e ndërhyrjeve me ankand, Banka lajmëron bankat dhe degët e bankave të huaja vetëm për rezultatin e pjesëmarrjes individuale në ankand.

Neni 17
Transaksionet valutore tregtare

1. Banka ndërmerr transaksione valutore tregtare vetëm pas marrjes së instruksioneve përkatëse në formë të shkruar ose mesazh *SWIFT*-i, nga përfaqësuesi i autorizuar i Qeverisë, i institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare dhe i klientëve të tjerë me të cilët kryen transaksione valutore tregtare.

2. Administratori përkatës i Bankës, jep paraprakisht miratimin e tij për transaksionet tregtare të ndërmarra në ditën e marrëveshjes midis Bankës dhe subjekteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, të cilat kalojnë vlerën 1 milion euro ose vlerën e njëjtë në valutë tjetër. Për transaksione me vlera më pak se 1 milion euro, miratimi jepet nga drejtuesit e Departamentit të Operacioneve Monetare.

3. Kursi i këmbimit me qëllim lidhjen e transaksioneve tregtare spot luhatet deri në ± 2.00 për qind të kursit të tregut, në momentin e lidhjes së marrëveshjes. Kursi i këmbimit për transaksionet *forward* të drejtpërdrejta ose transaksionet *forward* që janë pjesë e një marrëveshjeje *swap*, përcaktohet nga kursi *spot* dhe diferenca e normave të interesit të tregut për afatin e marrëveshjes, të monedhave të përfshira në transaksion, në përputhje me standardet ndërkombëtare të tregtimit.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

1. Me zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Komiteti, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse në Bankë.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.75, datë 11.10.2006 “Për miratimin e rregullores “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore””, të ndryshuar.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 14.2.2012
Doli nga shtypi më 16.2.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 24 lekë